



**Irena Nino**

**Komisioner Publik**

Znj. Irena Nino u lind në Shkodër, në vitin 1963. Kreu studimet e saj universitare në Universitetin e Tiranës, dega Drejtësi, ku u diplomua juriste në vitin 1985. Ka punuar 20 vjet në sistemin e Prokurorisë, Prokuroria e Rrethit Shkodër, Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Tiranës. Znj. Nino ka qenë anëtare e Komisionit të Pavarur të Monitorimit të Reformës në Drejtësi, i zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë.

Me vendimin nr. 62 të vitit 2021, të Kuvendit të Shqipërisë, është zgjedhur në detyrën e Komisionerit Publik.